



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.60/01-12951/21
Kaçanik, 21.05.2021

PROCES VERBAL

Nga mbledhja IV-të (katërt) e Rregullt e Komitetit për Komunitete për vitin 2021, mbajtur me datë 21 Maj 2021 (e Premte). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e Komiteteve të Kuvendit të Komunës, me fillim pune në ora 10:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin të gjithë , 7 anëtarë: Lirije Luta-PDK, Kaltrina Kodra- LVV , Nazife Krasniqi-LDK, Hajredin Luta-AAK, Naim Hysa- Kryqi i Kuq ,Elmihane Krasniqi – Malsiu nga OJQ HANDIKOS dhe Shemsedin Abazi - KMLDNJ . Mbledhjen e kryesoi Lirije Luta, Kryesuese e Komitetit për Komunitete. Procesmbajtëse: Arbnora Kuka, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, Fillimisht pëershëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e IV-të (katërt) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2021, data 21 Maj me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e 3 e vittit 2021 e Komitetit për Komunitete;
2. Të drejtat e qytetarëve në Komunën e Kaçanikut; dhe
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rrëth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Komitetit për Komunitete

APROVOJ

Redin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e 3 e vittit 2021 e Komitetit për Komunitete;

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, A keni ndonjë vërejtje rrëth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbali ? Prosesverbal i mbledhjes se III-të (tretë) të rregullt të Komitetit për Komunitete i vittit 2021, u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Komitetit për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se III të Komitetit për Komunitete të vittit 2021, të datës 21.04.2021 / Lënda : 01Nr.60/01-10902/21.

2. Të drejtat e qytetarëve në Komunën e Kaçanikut

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, Ne ishim te zyrtari për të drejtat e njeriut dhe për barazi gjinore, Vedat Dema.Sipas tij për shkak të Pandemisë Covid-19 nuk kan zhvilluar aktivitet. Nëse ka diçka rrëth kësaj pike urdhëroni.

Znj.Nazife Krasniqi, Kjo si temë ka qenë shumë me rëndësi, por për shkak të pandemisë Covid-19. Ne është dashur të mbajmë takim me qytetarë. Ne si komitet me pas shku në shpi të dikujt dhe e kishim cenuar edhe ligjin.Sipas informacioneve që na ka dhënë Vedati, nuk ka pasur aktivitet gati një vit. Te çështja e dhunës në familje është aktuale, si tematikë në gjithë Kosovën. Ndoshta me pas mundësi, kishim mundur të gjejmë një rast, por për shkak të pandemisë, nuk kemi mundësi. Ai na dha shënime në bazë të raportit të KKSBB-së që ishin vetëm 3 raste.

Znj.Kaltrina Kodra, Sipas atij reporti brenda 2 muajve, janë paraqitur 3 raste të dhunës në familje.

Znj.Elmihane Krasniqi-Malsiu, Ndoshta më e rëndësishme për ne do të ishte kjo temë, por nuk kemi punuar më shumë.Nuk është që nuk janë duke u shkelur të drejtat e qytetarëve. Informatat nga Vedati janë të pakta, por nuk është dashur të presim vetëm nga ai.Ne jemi pjesë e këtij vendi dhe e dimë si rjedhin gjërat dhe të drejtat e qytetarëve. Unë përfaqësoj personat me aftesi të kufizuara edhe aty janë duke u shkelur të drejtat, por edhe në grupe tjera siç janë gratë, besoj që ka shkelje, por edhe në grupe tjera. Te personat me aftesi të kufizuara kam material çka të flas, por jo çdoherë të flas vetëm për to se përfaqësojë të gjithë qytetarët. Edhe ju duhet të ngritni këtë çështje.Për grupet tjera nuk kam shumë material.

z.Shemsedin Abazi, Ne si këshill për mbrojtjen e lirive dhe të drejtat e njeriut, kemi pasur edhe zyrën e avokatëve. Ka pasur shumë shkelje të të drejtave. Në atë kohë më shumë ka qenë cenimi i të drejtës në punë. Edhe sot ka raste të ndryshme por nuk vijnë.Ka shkelje t drejtave në shumë aspekte.

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, Pse hezitojnë të vijnë qytetarët në KMLDNJ ?

z.Shemsedin Abazi, Ka prej atyre që mendojnë se vetëm lajmërohen dhe kurgja nuk ka. Ka forma por hezitojnë të vijnë.

Znj.Nazife Krasniqi, Ku duhet të vijnë?

z.Shemsedin Abazi, Ne kemi zyrën, por nuk ka ardhur askush.

z.Naim Hysa, Problemi kryesor është se nuk ruhet privatësia nga institucionet. Raportohet rasti dhe menjëher merret vesh. Është zyrtari për dhunë në familje në qendrën për punë sociale dhe aty duhet të lajmërohen rastet. Duhet të ketë zyre të veçant.Qytetarët hezitojnë të lajmërohen.

Znj.Nazife Krasniqi, Edhe nuk ruhet privatësia edhe nuk ka zgjidhje.Nuk ka ku të shkon gruaja pas lajmërimit të rastit. Nuk ka zgjidhje.

z. Hajredin Luta, Dhuna në familje, ne si komitet për komunitete nuk kemi kry aktivitet për shkak të Pandemisë Covid-19. Ka raste të shumta që femrës i shkelen të drejtat, por ajo femër nuk ka

guxim ta ngrit zérin në organe kompetente. Nëse femra ngrit padi ndaj burrit, ajo ska mbrojtje. Asaj duhet ti sigurohet banesa, ushqimi etj.

z.Naim Hysa, Jo vetëm gruaja , por edhe fëmija ka dhunë për shkak të prindërve. Duhet të ketë fushatë të gjerë që të eleminohet kjo çështje.

Znj.Elmihane Krasniqi-Malsiu, Në komunë është kutia e ankesave, a ka ndonjë ankesë?

z.Naim Hysa, Duhet të dijmë kush është përgjegjës për atë kuti, si funksionon?

Kryesuese e Komitetit, znj.Lirije Luta, Nëse nuk keni diçka tjetër lidhur me këtë pikë, kalojmë në pikën tjetër të rendit të punës.

4.Të ndryshme

Znj.Nazife Krasniqi, Te çështja e rasteve të fundit me abuzim, në komunën tonë nuk ka. Do të ishte mirë DAK të kontrollojnë, të mos ndodhin këto raste. E di që ka pasur rrrahje por për këto raste nuk kemi dëgjuar.

z.Naim Hysa, Si komitet nuk e di a jeni marrë me njerëz të sëmurë mendor, nuk kanë trajtim. Kemi një rast të sëmurë mendor, në fshatin Stagovë. Askujt nuk i intereson kjo kategori .Dikush duhet të merret me këtë kategori.

Znj.Elmihane Krasniqi-Malsiu, Në Kuvend është marrë vendim për ndërtimin e qendrës për këta persona.

Znj.Kaltrina Kodra, Është vetëm qendër rehabilituese për shëndetin mendor, që do të ndërtohet pranë QKMF-së.

z.Naim Hysa, Në spitalin për të sëmurë mendor, në Shtime nuk ka vend.

Znj.Elmihane Krasniqi-Malsiu, Nuk është mirë të dërgohen në Shtime, mund të marrin trajtim edhe këtu. Por ne si shoqëri duhe të dimë ti trajtojmë. Ne ende nuk e kemi vetëdijen e ngritur.

Znj.Lirije Luta, Ju faleminderit për pjesëmarrjen dhe e mbylli mbledhjen e IV-të për vitin 2021 të Komitetit për Komunitete në ora 11:00.

Procesmbajtës
Arbnora Kuka



Kryesuese e Komitetit
Lirije Luta